



**BASHKIA VORË
KRYETARI**

Nr. ~~1596~~ Prot

Vore me date 11 / 08 / 2008

KONTRATË SHËRBIMI PROJEKTIMI

“Studim projektim I rruges dytesore Vore - Koder Vore”

E lidhur sot më datë 11/08/ 2008 midis;

Bashkisë së Vorës, përfaqësuar nga z.Fiqiri ISMAILI, Kryetar i Bashkisë, me adresë qyteti Vore i mëposhtëquajtur “Investitori”

dhe

Shoqërisë Projektuese “G&K” SH.P.K e rregjistruar me Vendimin e Gjykatës Nr. 32250, datë 10.09.2004, NIPT K 51524045 N, me Liçencë Projektimi N. 4846/3, lëshuar nga Ministria e Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacionit, me vlefshmëri deri më datën 30.12.2009, përfaqësuar me prokure nr 9890 regj. Nr koll 522 date 09.07.2005 nga z. Dilaver OSHAFI, me seli te shoqërisë në adresën: Rruga “Siri Kodra”, Tirane, i mëposhtëquajtur “Projektues”

NENI 1

Baza ligjore

1.1 Kontrata hartohet në bazë të dispozitave ligjore të parashikuara nga nenet 850 dhe në vazhdim të Kodit Civil, si dhe dispozitave në fuqi për Prokurimin Publik.

NENI 2

Përkufizime

2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Investitorit dhe Projektuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti. i gjithë dokumentacioni i tenderit është pjesë përbërëse dhe integrale e kontratës së shkruar e të lidhur midis palëve.

2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që Investitori do t’i paguajë Projektuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha shërbimet që Projektuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

2.4 “Palë(t)” do të thotë nënshkruarit e kontratës.

2.5 “Investitor” do të thotë enti prokurues që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate bien shërbimet e projektimit.



- 2.6 “Projektues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate përmbush detyrimet e përcaktuara në këtë kontratë.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Projektuesi sipas kontratës për realizimin e projektit të zbatimit.
- 2.8 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike.

NENI 3

Objekti i Kontratës

3.1 Objekti i kësaj kontrate është shërbimi për realizimin e projekt zbatimit të plotë për objektin Studim projektim I ruges dytesore Vore - Koder Vore.

NENI 4

Çmimi

4.1 Çmimi përfshin të gjitha detyrimet fiskale që parashikon legjislacioni shqiptar.

- 4.2 Vlera totale e projektit është shuma 830 000 leke (teteqind e tridhjetë mijë) pa tvsh.

4.3 Vlera paraprake e realizimit të objektit është 58.048.419 leke(pesëdhjetë e tete milion e dyzet e tete mijë e katerqindentembedhjetë) lekë me T.V.SH.

NENI 5

Siguracioni i përgjegjësisë profesionale

5.1


NENI 6


Mënyra e Pagesës

6.1 Pagesa për shërbimin e projektimit do të bëhet si më poshtë:

- a) Shoqëria projektuese “G & K” shpk do të paguhet me 60% të vlerës totale të kontratës me shumë 498000 (katerqind e nentëdhjetë e tete mijë) lekë pa tvsh, në momentin e dorëzimit të projekt – zbatimit në variantin përfundimtar dhe të miratuar nga “Investitori”.
- b) Shoqëria projektuese “G & K” shpk do të paguhet me pjesën tjetër të vlerës së kontratës të pa paguar prej 40% të vlerës totale të saj, me shumë 332000(treqinde tridhjetë e dy mijë) lekë pa tvsh, në momentin e fillimit të zbatimit të projektit nga “Investitori”.
- c) Në rast se zbatimi i objektit nga “Investitori” nuk fillon brenda një afati kohor prej 365 ditësh kalendarike nga dita e dorëzimit të projekt-zbatimit nga firma projektuese, atëherë “Investitori” është i detyruar ti shlyejë Projektuesit pjesën prej 40% të projektit të pa paguar.

6.2 Pagesa do të bëhet me urdhër xhirimi pranë Bankës CREDINS, në numrin e llogarisë bankare të shoqërisë Projektuese Nr.24219 sipas skedarit të paraqitur në pikën 8.1.


Prr
Supervizim


REPUBLIKA E SHQIPËRIE
BASHKËSOJ
NORË

6.3 PAGESA për shërbimin e parashikuar në pikën 6.1/a të kësaj kontrate do të bëhet nga Investitori brenda 30 ditëve kalendarike nga dita kur projekt zbatimi është dorëzuar, dhe pranuar nga ana e tij.

6.4 PAGESA për shumën e parashikuar në pikat 6.1/b dhe 6.1/c të kësaj kontrate do të bëhet brenda 15 ditëve nga dita kur Investitori fillon të zbatojë projekt zbatimin e plotë të dorëzuar dhe pranuar nga Investitori ose brenda 15 ditëve nga dita kur kanë kaluar 365 ditë nga dita e dorëzimit e pranimin të projekt zbatimit.

6.5 Data e pagesës do të jetë dita që fondet debitoohen nga llogaria e Blerësit Publik.

NENI 7

Afati i dorëzimit të projektit

7.1 Projekti-zbatimi do të dorëzohet nga shoqëria projektuese në afat kohor prej 45 (njëzetënjë) ditësh kalendarike nga data e lidhjes së Kontratës.

7.2 Kontraktuesi brenda afatit kohor të parashikuar në pikën 13.2, duhet të paraqesë:

- Projekt- zbatimin në variantin përfundimtar.
- Specifikime teknike sipas zërave të punimeve.
- Relacionin teknik shpjegues për projektin.
- Preventivin e plotë sipas volumeve përfundimtare të punimeve.
- Grafikon paraprak të zbatimit të punimeve sipas projektit ku të parashikohet afati i përfundimit të punimeve të zbatimit.

7.3 Projekti do të merret në dorëzim nga sektori i urbanistikës në bashkinë Vore, të cilët do të verifikojnë atë dhe do të lëshojnë aktin e marrjes në dorëzim të projektit.

7.4 Projekt- zbatimi do të hartohet në tre kopje të barabarta dhe do të dorëzohet "Investitorit" në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.

NENI 8

Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

8.1 Me marrëveshje në shkrim midis palëve, afati i dorëzimit të projektit mund të zgjatet.

8.2 Në rast se palët bien dakort të zgjasin afatin e dorëzimit të projektit në ditën e fundit të dorëzimit të projekt zbatimit, Investitori nuk do të aplikojë mbi Projektuesin kamat vonesën e përcaktuar në nenin 8 "Sanksionet"


8.3 Afati i kontratës zgjatet automatikisht në rastin e Forcës Madhore. Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Projektuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë por nuk limitizohen në lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

8.4 Investitori mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Projektuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Projektuesi duhet të njoftojë menjëherë Investitorin me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Investitori duhet të vlerësojë kërkesën. Në se Investitori është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi menjëherë pas dërgimit të shkresës ku miratohet zgjatja e afatit për dorëzimin e projektit.

NENI 9

Sanksione

Projektim, Supervizim



9.1 Për çdo ditë vonesë të dorëzimit të projektit nga shoqëria projektuese do të aplikohet kamat vonese në masën 0.4% të vlerës totale të kontratës.

9.2 Për çdo ditë vonesë në shlyerjen e pagesës nga ana e "Investitorit", do të aplikohet kamat vonesë në masën 0.1% të vlerës totale të Kontratës.

9.3 Investitori mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Projektuesit. Në rast të tillë Investitori duhet t'i japi Projektuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

NENI 10

Të drejtat dhe detyrimet e Projektuesit

10.1 Projektuesi do të hartojë Projekt- zbatimin në tre kopje të barabarta dhe do të dorëzohet "Investitorit" siç parashikohet në kushtet e kësaj kontrate.

10.2 Projektuesi është i detyruar t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të Investitorit, në rradhë të parë në lidhje me cilësinë e projektit, si dhe problemeve që mund të dalin gjatë zbatimit të projektit në objekt.

10.3 Projektuesi është i detyruar të marrë parasysh dhe të zbatojë të gjitha detyrat dhe udhëzimet e lëna nga Oponenti mbi projektin.

10.4 Projektuesi është i detyruar të marrë në konsideratë dhe të pasqyrojë në projektin e zbatimit të objektit të gjitha zgjerimet që mund të lihen nga KRR.T.T. në lidhje me projektin dhe preventivin.

10.5 Projektuesi duhet të kryejë me mjeshtëri, kujdes dhe përkushtim të gjitha detyrimet e kësaj Kontrate.

10.6 Gjatë zbatimit të projektit, Projektuesi është i detyruar të marrë miratimin e Investitorit për ndryshime të projektit të cilat kanë ndikim në kosto, cilësi dhe kohë të projektit fillestar.

10.7 Projektuesi nuk ka të drejtë të jap projektin për përdorim apo shitje personave të tjerë të tretë pa marrë miratimin e Investitorit, i cili ka të drejtën e pronësisë mbi projektin e hartuar nga Projektuesi.

10.8 Projektuesi ka të drejtë t'i kërkojë Investitorit pagesën për projektin e hartuar prej tij në përputhje me nenin 4 të kësaj kontrate.

NENI 11

Të drejtat dhe detyrimet e Investitorit

11.1 Investitori ka të drejtë ti kërkojë Projektuesit dorëzimin e projekt-zbatimit brenda afatit të parashikuar në pikën 7.1 të kësaj kontrate.

11.2 Investitori ka të drejtë ti kërkojë Projektuesit rishikimin e projektit në rast se ai nuk i përgjigjet kërkesave teknike të parashikuara nga Investitori në dokumentat e tenderit. Esi dhe nga Këshilli Teknik i Bashkisë Tiranë si Oponent i projektit.


Projektim, Supervizim


REPUBLIKA E SHqipëRIE
BASHKIA E TIRANË
KORRE 4

11.3 Investitori ka të drejtë t'i kërkojë Projektuesit të rishikojë projektin dhe të japë mendime në rast se gjatë zbatimit të objektit dalin probleme që kanë të bëjnë me projektin.

11.4 Porositësi është i detyruar t'i japë në kohën e duhur Projektuesit informacionin e nevojshëm që ka në dispozicion, me qëllim realizimin e projektit.

11.5 Investitori është i detyruar të kryej pagesën për shërbimin e projektimit në përputhje me pikën nën 6 "Mënyra e pagesës" të kësaj kontrate.

NENI 12

Pronësia e projektit

12.1 Çdo gjë e dhënë ose e paguar për projektin nga Investitori, si dhe vetë projekti do të jenë pronë e Investitorit Bashkia Tiranë dhe si e tillë do të konsiderohen kudo që do të përdoren ato.

NENI 13

Sigurimi i Kontratës

13.1 Sigurimi i Kontratës do të jetë në masën 10% të vlerës totale të Kontratës. Kjo garanci ngurtësohet nga Projektuesi për llogari të Investitorit, si garanci për realizimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Kontratë.

13.2 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Projektuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së dorëzimit dhe pranimit të projektit nga Investitori.

NENI 14

Dispozita të fundit

14.1 Palët meren vesh midis tyre vetëm me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

14.2 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve do të bëhet me mirëkuptim në rast të kundërt palët e mësipërme do t'i drejtohen Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë.

14.3 Kjo kontratë përpilohet në kater kopje të barabarta prej të cilave 3 kopje i mban Investitori dhe 1 kopje Projektuesi.

14.4 Kjo kontratë hyn në fuqi menjëherë mbas nënshkrimit të saj nga palët.

PROJEKTUESI

"G & K" SH.P.K.

DIJAVER OSHAFI

Me prokuror

Projektim, Supervizim

INVESTITORI

BASHKIA E VORES

FIQIRI ISMAILI

KRYETAR

VORE